



Prishtinë: 28.03.2019
Kodi i ZRRE-së: V_1129_2019

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Duke u bazuar në:

- Nenin 9, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.7, nenin 15 dhe 17 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr. 05/L-084);
- Nenin 17 dhe 18 të Rregullës për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë;
- Vendimi i DMK-së të ZRRE-së: **ZRRE/DMK_V_1897_02_19**;
- Ankesa e KESCO-së e datës **15.03.2019**.

në seancën e mbajtur më datë 28.03.2019, nxori këtë:

V E N D I M

- I **REFUZOHET** ankesa e konsumatorit L. M. nga Vitia e Kllokotit me shifër të konsumatorit DGL - 9033238 ndaj vendimit të DMK-së, si e pa bazuar.
- II **MBETET në fuqi** vendimi i Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve nr. **ZRRE/DMK_V_1897_02_19** i datës 13.02.2019.

A r s y e t i m

Zyra e Rregullatorit për Energji me datë 15.03.2019 ka pranuar ankesën e parashtruar nga konsumatori L.M., i cili ka kundërshtuar vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve në ZRRE si vendim i shkalës së parë. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se disa herë ka kërkuar nga furnizuesi i energjisë elektrike që të bëjë kontrollimin e njehsorit elektrik për shkak të faturave të larta të energjisë elektrike por që derisa është djegur askush nga kompania nuk ka ardhur për kontrollim të njehsorit elektrik. Konsumatori në ankesën e tij ka theksuar se njehsori i tij ka regjistruar dukshëm energji elektrike më shumë se sa njehsori i ri dhe se nuk pajtohet me konstatimin se njehsori elektrik ka regjistruar për 33.33 %. Konsumatori ka theksuar se KEDS ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe kodet në fuqi. Konsumatori ka theksuar se krahasimi i energjisë së shpenzuar të bëhet për periudhën para djegies së njehsorit elektrik me shpenzimin e energjisë pas ndërrimit.

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji në mbledhjen e mbajtur me datë 28.03.2019 ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të prezantuara nga palët në kontest si dhe vendimin e Departamentit për Mbrojtjen e Konsumatorëve dhe pas kësaj ka vërtetuar se vendimi i DMK-së si vendim i shkalës së parë është vendim i drejtë dhe i bazuar në prova konkrete.

Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit kërkuar nga furnizuesi i energjisë elektrike që të bëjë kontrollimin e njehsorit elektrik për shkak të faturave të larta të energjisë elektrike, Bordi i ZRRE thekson se punëtorët e autorizuar të KEDS-it për ndërrim njehsori me datë 24.02.2016 kanë inspektuar pikën matëse të konsumatorit, ku kanë larguar nga matja njehsorin elektrik nr.35018832 me gjendje TL=33730 kWh dhe TU=014539 kWh, si dhe kanë vendosur për matje njehsorin elektrik nr.64646861



me gjendje TL=000000 kWh dhe TU=000000 kWh. Bordi i ZRRE thekson se në procesverbalin e ndërrimit të njehsorit elektrik të lartcekur punëtorët e autorizuar të KEDS përveç të dhënave teknike kanë evidentuar që njehsori i larguar nga matja është i djegur nga mbrapa.

Sa i përket pikës tjetër të kundërshtimit të KEDS-it se njehsori i tij ka regjistruar dukshëm energji elektrike më shumë se sa njehsori i ri dhe se nuk pajtohet me konstatimin se njehsori elektrik ka regjistruar për 33.33 %, Bordi i ZRRE-së thekson se ka analizuar me kujdes procesverbalin e shqyrtimit të saktësisë së matjes nr.org.02 nr.17242 të datës 19.10.2016 dhe konstaton se punëtorët e autorizuar të KEDS-it kanë bërë shqyrtimin e saktësisë së matjes së njehsorit elektrik nr.35018832, dhe gjatë shqyrtimit kanë konstatuar se: njehsori elektrik nuk është në rregull, njehsori elektrik është i djegur, është i dëmtuar nga ana e jashtme, led diodën e ka në prishje, bllobat (vulat) i ka në rregull, si dhe gabimi në matje është -33.15%. Gjithashtu Bordi i ZRRE ka analizuar edhe procesverbalin e kontrollimit detal të njehsorit elektrik nr.org. 02 nr.18292 të datës 31.10.2016 në të cilin procesverbal është konstatuar se njehsori elektrik bllobat (vulat) i ka në rregull, nga ana e jashtme njehsori shtëpizën e poshtme e ka të djegur, si dhe në brendi të njehsorit komisioni ka vërejtur se bobina e fazës L2 është e djegur dhe si pasojë njehsori elektrik ka regjistruar energji elektrik për 33.33% me pak. Pra, Bordi i ZRRE thekson se në të dy procesverbalet konstatohet se njehsori elektrik nr.35018832 ka regjistruar më pak energji elektrike për 33.33%. Ndërsa sa i përket pohimit të konsumatorit se njehsori elektrik i tij ka regjistruar energji elektrike dukshëm më shumë se sa njehsori i ri, Bordi i ZRRE konstaton se ky qëndrim nuk është i saktë, ngase sipas analizave të bëra rrjedhës së energjisë elektrike për periudhat kontestuese me njehsorin e vjetër elektrik nr.35018832 dhe njehsorët e ri elektrik nr. 64646861 dhe nr.32600707 për periudha të njëjta kohore, konstatohet se ka luhatje dhe ndryshim të shpenzimeve të energjisë elektrike. Pra bazuar në krahasimet e bëra konstatohet se sipas krahasimeve të bëra për periudha të njëjta kohore me njehsorin elektrik nr.64646861 ka rritje prej 54% krahasuar me njehsorin nr.35018832, kurse me njehsorin elektrik nr.32600707 krahasuar me njehsorin nr.35018832 ka rritje prej 66%.

Bordi i ZRRE informon gjykatën se sipas rrjedhës së energjisë elektrike mesatarja e shpenzimeve me njehsorin elektrik nr.35018832 (njehsori kontestues) për periudhën 04/2014 deri në periudhën 12/2014 është **1,631 kWh/muaj**, si dhe periudhën 04/2015 deri në periudhën 12/2015 është **2,062 kWh/muaj**, kurse me njehsorin e ri elektrik nr.64646861 periudha 04/2016 deri në periudhën 12/2016 është **2,764 kWh/muaj**, si dhe periudha 04/2017 deri në periudhën 12/2017 është **2,937 kWh/muaj**, si dhe me njehsorin elektrik nr.32600707 i cili është vendosur për matje në periudhën 03/2018 mesatarja e shpenzimeve për periudhën 04/2018 deri në periudhën 12/2018 është **3,072kWh/muaj**. Pra Bordi i ZRRE thekson se bazuar në analizën e bërë rrjedhës së energjisë elektrike aktive shihet qartë se me njehsorët e ri nr.64646861 dhe nr.32600707 kemi rritje të shpenzimit në krahasime me njehsorin elektrik kontestues nr.35018832

.Sa i përket pikës së kundërshtimit të konsumatorit se KEDS ka vepruar në kundërshtim me rregullat dhe kodet në fuqi, Bordi i ZRRE thekson se KEDS ka vepruar konform Rregullave dhe Kodeve në fuqi, pasi që pas djegies së njehsorit elektrik kanë dalur te konsumatori dhe kanë bërë ndërrimin e njehsorit elektrik dhe kanë vendosur njehsorin e ri. Gjithashtu duhet theksuar se KESCO ka vepruar drejt përkatësisht bazuar në procedurat dhe kodet në fuqi sipas së cilave në rastet kur konstatohet se ka defekt në sistemin matës, atëherë duhet të bëhen të gjitha korrigjimet e nevojshme duke bërë ri llogaritjen e energjisë përkatësisht përmirësimi i faturimit e që për konsumatorët komercial përfshin periudhën një vjeçare.



Bordi i ZRRE, gjithashtu ka konstatuar se konsumatori në ankesën e tij nuk ka ofruar asnjë provë bindëse për të vërtetuar faktin se vendimi i DMK-së si organ i shkallës së parë nuk është vendim i drejtë dhe i bazuar në ligje dhe rregulla, por që i njëjti në ankesë vetëm se ka kontestuar vendimin e shkallës së parë në mënyrë të përgjithësuar pa ofruar prova të arsyeshme dhe duke u thirrur vetëm në kushte të vështira ekonomike.

Bordi i ZRRE-së në mbledhjen e mbajtur me datë 30.10.2018 pas analizimit të krejt asaj që u theksua më lartë, ka vendosur si në dispozitivin e këtij vendimi.

- III. Vendimi nxirret në gjuhën shqipe dhe do të përkthehet në gjuhën serbe dhe angleze. Në rast të mospërputhjes në mes të versioneve, do të mbisundojë versioni në gjuhën shqipe.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.

Këshillë Juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodhë e fundit.

Bordi i ZRRE-së:

Arsim Janova, u.d. kryesues

Besim Sejfiqaj, anëtar

Selman Hoti, anëtar

Izet Rushiti, anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Konsumatorit L. M.,
- KESCO-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.